REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 739120
Datë/Datum. 13.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Majlinda Bedrolli ***Ekspert shqyrtues***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***05.10.2020***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***13.10.2020***	***Nr. i lëndës:*** ***739/20***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 01.10.2020, OE **N.N.SH "Top Projekt" -Prishtinë** ka parashtruar ankesë me nr: **739/20,** kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE **"EdiBau-Ing " sh.p.k** lidhur me aktivitetin e prokurimit: ***"Furnizim me material ndertimore per ndertimin e disa shtepive te familjeve skamnore ne Prizren",*** me nr. të prokurimit***: 622-20-1764-1-1-1***, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prizrenit.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 450.000,00 €

Për këtë aktivitet të prokurimit, PSH me datën 03.09.2020, ka nxjerr vendimin me nr. **499/20.**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë 05.05.2020, data e hapjes së ofertës 15.06.2020, data e njoftimit për dhënien e kontratës 09.07.2020, kërkesa për rishqyrtim me dt 22.09.2020, vendimi për refuzim të kerkeses për rishqyrtim 25.09.2020.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE pretendon se AK, nuk ka respektuar dispozitat e LPP-së dhe atë:
Neni 7,56,59,60,61,65,66, 72 dhe 108/A të LPP-së

DEKLARATA DETALE E ANKESES

1.Lidhur me pretendimin e OE ankues N.N.SH "Top Projekt" – Prishtinë se gjatë ri-vlersimit të tenderit AK ka shkelur nenin 7,56,59,60,61,65, 66 dhe 72 të LPP-së, duke shpallur fitues OE "EdiBau-Ing " sh.p.k, i cili rezulton i papërgjegjshëm duke mos i plotësuar ''Kërkesat mbi mundësit teknik dhe/ose professional- Kapaciteti teknik dhe professional'' dhe çmim jo –normalisht të ulët.

Prova Matriale 1

Operatori ekonomik ka dështuar të plotësojë "Kërkesat mbi mundësit teknik dhe/ose professional- Kapaciteti teknik dhe professional" ku kërkohet:

Kërkesa 3. të ketë së paku 20 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare 3. Nën pikën b Lista e të punësuarve, së bashk me kontratat e punës, për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt.

2.Lidhur me pretendimin e OE ankues N.N.SH "Top Projekt" – Prishtinë se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në dokumentacionin e tenderit ka prezantuar listën e të punsuarve nga ATK-ja me numër protokolli ATK-PZ nr 62 dt.10.04.2020, ku në listë janë të evidentuar se OE posedon të punësuar një staf prej vetëm 10 personave, rrjedhimisht nuk e plotëson nenin 9.1&9.2 tek Kërkesat mbi mundësit teknik dhe/ose profesional dhe rrjedhimisht është i papërgjegjshëm.

Operatori ekonomik ka prezantuar një Listë të stafit dhe kontratat e punës për të gjithë punëtoret gjatë analizimit me kujdes të kësaj liste konstatojmë se kjo liste dhe kontratat e ofruara nga OE nuk përputhen me listën e deklaruar në ATK. Shumica e kontratave fiktive te prezantuara janë në afat të pacaktuar por shumica të nënshkruara në vitet 2016,2017,2018,dhe 2019 me çrast në të dy operatori ekonomik ose ka ofruar kontrata fiktive ose ka mashtruar autoritetet tatimore të kosoves me me çrast në të dy rastet në bazë të LPP-së i papërgjegjshëm.

Gjatë rivlerësimit AK në bazë të nenit 72 ka kërkuar sqarime tek OE "EdiBau-Ing " sh.p.k përmes letres standarde për sqarime të tenderit me dt 16.09.2020 ku kërkon sqarime shtesë.

Kërkesa 3. të ketë së paku 20 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare 3. Nën pikën b Lista e të punësuarve, së bashk me kontratat e punës, për

stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt.

Në përgjigje të letres standarde OE ka ofruar ne kopje fizike tek AK nje listë te re të ATK-së të dt 16.09.2020 ku në muajin gusht figuron se OE ka 22 të punsuar dhe ka ofruar kontratat per ketet projekt ne kopje fizike me dt 16.09.2020-Kontrata që nuk kan ekzistuar më parë.

I bejm me dije AK-së se ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, neni 72 pika 3 ku thuhet: "*Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive*". Pra AK nuk mundë të kërkojë OE të sjellë dokumente ekzistenca e të cilave nuk mundë verifikohet se dokumenti i tillë ka ekzistuar para njoftimit për kontratë një gjë e tillë përjashtohet kategorikisht per deklaraten enen betim kontratat mbi veper nënshkrimi dhe vulosja e paramases etj etj.

Gjatë analizimit të listes se puntorve të ofruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së konstatojm

- Kontratat të punëtorve të rregullta sië kërkohet në DT janë 10 cop
- Kontratat të punëtorve të skaduara 11 cop
- Kontratat të punëtorve të skaduara dhe të plotësuara me kontrata në kundërshtim me LPP-në mbi veper janë 14 cope, rrjedhimisht OE është i papërgjegjshëm.

Bashkangjitur gjeni proven materiale 2

3.Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë për pozicionin 1.Pastrimi i terrenit me makine dhe germimi i dheut siperfaqesor në trashësi deri në 30 cm. Humusi deponohet në deponi të posaçme ndersa teprica e dheut transportohet ne deponin e qytetit. OE ka ofruar çmimin tejet të ulët dhe jo serioz në vlerë prej 0.20 euro/metër kub kur dihet se çmim i tregut është së paku 10-15 herë më i lartë.

Për pozicionin 2. Gërmimi i dheut për hapje te themeleve shiritore deri ne nivelin e kerkuar ne projekt. Ne llogari te merret edhe transporti I dheut deri ne deponi. OE ka ofruar çmimin tejet të ulët dhe jo serioz në vlerë prej 0.50 euro/metër kub kur dihet se çmim i tregut është së paku 4-6 herë më i lartë.

Në bazë të LPP-së Rregullat për Tender Jo-Normalisht të ulët, Neni 4 Procedurat e Shqyrtimit (interpartes) 4.2 *Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila*

përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".

Rrjedhimisht OE është i papërgjegjshëm dhe atë në bazë të nenit 61 të LPP-së Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

4.Lidhur me pretendimin e OE ankues N.N.SH "Top Projekt" -Prishtinë se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në dokumentacioni e tenderit ka emeruar inxhinierin Besim Bytyqi si projekt menagjer per këtë projekt duke ofruar kontratë pune e nënshkruar me dt 15.06.2020. Në këtë kontratë nuk specifikohet hyrja në fuqi e kësaj kontrate eas fundi i vlefshmeris dhe rrjedhimisht kjo kontratë është në kundërshtim me ligjet në fuqi në Republiken e Kosoves dhe si pasoj është e pa vlefshme, rrjedhimisht OE është i papërgjegjshem. Gjithashtu në DT e tenderit është kërkuar që te prezantohen CV-ja e inxhinierit dhe referencat për punet e kryera ku per inxhinieri Besim Bytyqi OE ka prezantuar referenca per ndertimin e rruges dhe asnjë referenc për natyren e kontratës në fjalë, rrjedhimisht OE është i papërgjegjshem.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Kapaciteti teknik dhe professional: 9.1&9.2	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 650.000,00 €	Dëshmia 1. **Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, , të deshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e furnizimeve dhe punëve të ndërtimit dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të furnizimeve dhe punëve ndërtimore**
Kerkesa 2. **Në kuadër të stafit duhet të emrohet me vendim menaxheri për këtë projekt i cili duhet të jetë Inxhinjer i diplomuar i ndërtimtarisë ose master drejtimi konstruktiv me jo më pak se 5 vite pune në profesion. Të ketë menagjuar së paku një projekte të natyrës së kontratës.**	Deshmia 2. **Nën pikën a Diploma e fakultetit kopje, referencat për periudhën e kaluar në profesion së paku për 5 vite, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit me OE për këtë projekt, a.Diploma, CV dhe kontrata e punës ose e bashkëpunimit për këtë projekt**
Kerkesa 3. **Të ketë së paku 20 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës. a. Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të ketë minimum 60 % të referencave të natyrës së kontratës. si dhe 60 % e stafit të kërkuar për këtë projekt** **Kërkesa 4. OE duhet të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a. dy kamionë të tonazhit të mesëm b. Një kamion vetngarkues i**	Deshmia 3. **Nën pikën b Lista e të punësuarve, së bashk me kontratat e punës, për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt. c. pajisjet të cilat regjistrohen duhet të kenë libreza të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, pajisjet tjera duhe të sjellë dëshmi mbi pronësinë e tyre ose dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve Dëshmija 4 Certifikata ISO 9001 (lëmia e ndërtimit), për sistemin menaxherial të cilësisë, f. Certifikata ISO 14001 (lëmia e ndërtimit), për sistemin menaxherial të ambientit,**

tonazhit të mesëm e. një bager gropues I tonazhit të mesëm. **Kërkesa 5. Certifikata ISO 9001 (lëmia e ndërtimit), për sistemin menaxherial të cilësisë, f. Certifikata ISO 14001 (lëmia e ndërtimit), për sistemin menaxherial të ambientit,**	

4. RAPORTI I KOMISIONIT RI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim: Komuna e Prizrenit, shpërblen me kontratë OE "EdiBau-Ing " sh.p.k, në vlerë totale prej 335.530,20 euro.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Komuna e Prizrenit, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës pas ri vlerësimit te ofertave. Kundër të njëjtit njoftim parashtruesi i ankesës ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek AK- Komuna e Prizrenit, sipas afateve të parapara me LPP. AK, përmes vendimit ka refuzuar kërkesën si të pa bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues N.N.SH "Top Projekt" -Prishtinë

Fillimisht eksperti shqyrtues sqaron se kemi të bëjmë me ankesë të përsëritur, ku palët e përfshira në procedur janë të njëjta, rrjedhimisht disa nga pretendimet ankimore tani veç i kemi trajtuar. Po ashtu, edhe paneli shqyrtues këto pretendime ankimore i ka gjykuar me vendimin e dates 03.09.2020, me nr. **499/20.**

Përkatësisht pretendimi ankimor kundrejt kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional, *Kerkesa 3. **Të ketë së paku 20 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës. a. Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të ketë minimum 60 % të referencave të natyrës së kontratës. si dhe 60 % e stafit të kërkuar për këtë projekt***

*Deshmia 3. **Nën pikën b Lista e të punësuarve, së bashk me kontratat e punës, për stafin e ri kontratat e***

bashkëpunimit për këtë projekt. Eksperti shqyrtues sqaron se Paneli Shqyrtues në vendimin PSH.nr.499/20 ka konstatuar:

> *"Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas analizimit të kërkesës mbi mundësitë teknike dhe profesionale siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe listën e kontratave së bashkur me kontratat e punës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, kjo kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë që operatori ekonomik duhet të kenë së paku 20 të punësuar me profile të ndryshme me listën e të punësuarve së bashkur me kontratat e punës, ndërsa për stafin e ri kontratat duhet që operatori ekonomik të posedojë kontrata e bashkëpunimit për këtë projekt apo këte aktivitet të prokurimit. Lidhur me këtë kërkesë të dosjes se tenderit, OE i rekomanduar për kontratë ka bashkangjitur listën e punëtorve të deklaruar në ATK, ku në këtë listë të vitit 2020 e nxjerr në ATK para dorzimitë të ofertës dhe të vulosur nga ATK, janë të deklaruar vetëm 10 punëtor. Ndërsa, sa i përket pikës tjetër të kësaj kërkese në dosjen e tenderit që ka të bëjë me stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt, Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka të bashkangjitur kontratat për 25 punëtor, ku këto kontrata që të gjitha janë para vitit 2019 dhe asnjëra prej këtyre kontratave nuk ka të bëjë me këtë projekt sikurse është kërkuar në dosje të tenderit që për stafin e ri duhet kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar".*

Kurse, në pjesën e fundit të arsyetimit në këtë vendim është cekur:

> *...Obligohet AK që gjatë rivlerësimit të ofertave të iu përmbahet në tërsi dispozitave të LPP-së, duke u bazuar në kërkesat të cilat i ka përcaktuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë si dhe mos të devijoj nga kërkesat e përcaktuara në dosje e tenderit duke vepruar në kundërshtim me këto kërkesa të cilat vet AK i ka vendosur në dosjen e tenderit...".*

Eksperti shqyrtues sqaron se AK përmes procesit të ri vlerismit ka kërkuar sqarime shtesë përmes letës standarde për sqarimet e tenderit me datë 16.09.2020, nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me këtë kërkesë për punëtorët e kërkuar përmes FDT-se. OE i ri rekomanduar për kontratë është përgjigjur dhe ka prezantuar listë të re ATK-së, të dt.16.09.2020, me gjithesej 22 punetor te përshkruar, per periudhën kohore deri ne muajin Gusht 2020 (para hapjes se ofertave). Ne te njëjtën list (ATK-se) jan te evidentuar emrat e punetoreve te përshkruar edhe ne listes se prezantuar ne oferte nga OE edhe tani i rekomanduar per dhënie te kontratës. Poashtu operatori ekonomik i rekomanduar per dhënie te kontratës përmes sqarimeve ka prezantuar edhe kopjet e kontratave ne emer te punetoreve te prezantuar ne list me përshkrim se te njëjtit do

te angazhohen ne kete aktivitet te prokurimit.

Prove bashkangjitur me raport, gjeni kopjen e listës e ATK-së të dt.16.09.2020, periudha 2020, si dhe kopjen e listes të ATK-së, të dt.10.04.2020 periudha 2020 dhe listen e punëtorve.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues që ka të bëjë me pozicionin 1 dhe 2 të paramases ku OE i rekomanduar për kontratë për pozicionin 1 ka ofruar çmimin tejet të ulët dhe jo serioz në vlerë prej 0.20 euro/metër kub kur dihet se çmim i tregut është së paku 10-15 herë më i lartë. Kurse, për pozicionin 2 OE i rekomanduar ka ofruar çmimin tejet të ulët dhe jo serioz në vlerë prej 0.50 euro/metër kub kur dihet se çmim i tregut është së paku 4 - 6 herë më i lartë.

- Eksperti shqyrtues sqaron se paneli shqyrtues përmes vendim PSH.nr.499/20 ka konstatuar: "... "Rregullat për tenderët Jo-normalisht të ulët" *nuk zbatohen për pozicione të caktuara por për tenderët të cilët në shikim të parë duken për autoritetin kontraktues si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat ka gjasa për një performancë të keqe të kontratës. Po ashtu, kjo rregull gjen zbatim në rastet kur çmimi i ofruar është mbi 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm ose çmimi i ofruar është mbi 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët apo janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tender...*". Andaj, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është "res judicata".

Lidhur me pretendimin e fundit të OE ankues N.N.SH "Top Projekt" – Prishtinë, se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në dokumentacionin e tenderit ka emeruar inxhinierin Besim Bytyqi si projekt menagjer për këtë projekt duke ofruar kontratë pune e nënshkruar me dt 15.06.2020. Në këtë kontratë nuk specifikohet hyrja në fuqi e kësaj kontrate e as fundi i vlefshmerisë dhe rrjedhimisht kjo kontratë është në kundërshtim me ligjet në fuqi në Republiken e Kosoves dhe si pasojë është e pa vlefshme. Gjithashtu, në dosjes e tenderit është kërkuar që të prezantohen CV-ja e inxhinierit dhe referencat për punët e kryera, ku OE për inxhinierin Besim Bytyqi ka prezantuar referenca për ndërtimin e rrugës dhe asnjë referencë për natyrën e kontratës në fjalë, rrjedhimisht OE është i papërgjegjshem.

- Eksperti shqyrtues sqaron se tek kërkesa mbi kapacitetit teknik dhe profesional, konkretisht në kërkesën nr.2, AK ka kërkuar: *"Në kuadër të stafit duhet të emrohet me vendim menaxheri për këtë projekt i cili duhet të jetë Inxhinjer i diplomuar i ndërtimtarisë ose master drejtimi konstruktiv me jo*

më pak se 5 vite pune në profesion. Të ketë menagjuar së paku një projekte të natyrës së kontratës. Deshmia 2. Nën pikën a Diploma e fakultetit kopje, referencat për periudhën e kaluar në profesion së paku për 5 vite, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit me OE për këtë projekt, a.Diploma, CV dhe kontrata e punës ose e bashkëpunimit për këtë projekt"

Lidhur me këtë kerkesë OE i rekomanduar për kontatë ka caktuar me vendim si projekt menagjer inxhinierin z. Besim Bytyqi, ku i njejti posedon kualifikimin arsimor sipas kërkesës së FDT-së dhe ka kontratë pune me OE të rekomanduar për kontratë. Sa i përket pikës së kërkesës "*të ketë menagjuar së paku një projekte të natyrës së kontratës*", OE i rekomanduar ka bashkangjitur referencat dhe CV e inxhinierit, ku i njëjti ka qenë mbikqyrës dhe menagjer i projektit në konstruktimin e rrugëve dhe punëve tjera ndërtimore, që për mendimin e ekspertit shqyrtues e plotëson këtë kërkesë të AK-së.

Prove, bashkangjitur gjeni, kopjen e kontratës, Cv, Referencen dhe Vendimin per caktim te menagjerit te projektit, ne emër te z. Besim Bytyçi.

Përfundimisht sipas asaj qe u përshkrua si me larte sqarojmë se AK, kërkesat e aplikuara kundrejt operatoreve ekonomik nuk jan relevante dhe proporcionale në raport me lënden e kontratës përkatëse (shiqo nenin 51, të LPP-së), konkretisht kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesionale që nderlidhen me stafin ku është kërkuar "Për stafin e ri kontrata e bashkëpunimit për këte projekt". Në këte faz të aktivitetit të prokurimit, kontrata palët e përfshira në të i fut në mardhenje të detyrimeve, rrjedhimisht AK, ka qen dashur ti lejoj ofertuesit qe të ofertojn me para kontrata, megjithatë kërkesa e njëjte nuk është kontestuar nga ndonjë OE i interesuar për këte aktivitet të prokurimit.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e dhëna në këte raport propozimi ynë është qe ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, dhe ti lejohet AK-së të procedoi tutje me aktivitetin e prokurimit, konform dispozitave të LPP-së.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prizrenit.
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues -"Top Projekt" - Prishtinë

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

LISTA E PAGAVE PËR KOMPANINË

ATK-KS\veberish

4/10/2020 11:15:20 AM

NR FISKAL	810974403
EMRI I KOMPANISË	EdiBaU- Ing
ADRESA	UKË BYTYÇI PN
LLOJI I BIZNESIT	JURIDIK
QENDRA TATIMORE	PRIZREN 1
VITI	2020

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije
Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosova
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit: ATK-P1
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.: 62
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: 1
Data / Datum / Date: 10.04.2020
PRIZREN

					MUAJT											
NR	EMRI	MBIEMRI	NR PERSONAL	PRIMARE	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	ENVER	DEMIRAJ	1016502754	PO	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2	ARBEN	SPAHIJA	1003223635	PO	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	MERGIME	KRASNIQI	1231742812	PO	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	BUJAR	SPAHIJA	1003223376	PO	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	ALBERT	DULAKU	2172107217	PO	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
6	FITORE	KRASNIQI	1176723579	PO	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
7	ASLLAN	SELLAJ	1172740240	PO	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
8	NGADHËNJIM	HOTI	1176325557	PO	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
9	BAHRIJE	SPAHIJA	1002937774	PO	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
10	FITIM	RUSI	1241048191	PO	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
SH.P.K.
EDIBAU-ING
PRIZREN

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova -Tax Administration of Kosovo

Lista e Punëtorëve

Periudha	2020
Numri Fiskal	810974403
Kontakti	BUJAR SPAHIJA
Tatimpaguesi	EdiBaU- Ing
Adresa	UKË BYTYÇI PN
Regjioni	PRIZREN 1
Tel	044/144-454
Lloji Kompanisë	SH.P.K.
Aktiviteti	Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore

Nr.	Emri	Nr. Personal	Primaro	PUSHIM 1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	AFRIM GEGAJ	1232142070	PO	-	-	-	+	+	+	+	+	-	-	-	-
2	ALBERT DULAKU	2172107217	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
3	ARBEN SPAHIJA	1003223535	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
4	ARDIT DEMIRAJ	1242506663	PO	-	-	-	+	+	+	+	+	-	-	-	-
5	ASILAN SELLAJ	1172740240	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
6	AVNI MUSAJ	1016501910	PO	-	-	-	+	+	+	+	+	-	-	-	-
7	BAHRIJE SPAHIJA	1002937774	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
8	BESIM ZOGAJ	1232126279	PO	-	-	-	+	+	+	+	+	-	-	-	-
9	BUJAR SPAHIJA	1003223376	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
10	ENVER DEMIRAJ	1016502754	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
11	FADIL MUSAJ	1016504567	PO	-	-	-	+	+	+	+	+	-	-	-	-
12	FITIM RUSI	1241048191	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
13	FITORE KRASNIQI	1176723579	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
14	LAVDIM BUGARI	1244607103	PO	-	-	-	+	+	+	+	+	-	-	-	-
15	LEONARD KASTRATI	1176704701	PO	-	-	-	+	+	+	+	+	-	-	-	-
16	LULZIM BYTYÇI	1233941405	PO	-	-	-	+	+	+	+	+	-	-	-	-
17	MERGIME KRASNIQI	1231742812	PO	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-	-
18	NGADHËNJIM HOTI	1176325557	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
19	ORSALIJA UKAJ	1234549562	PO	-	-	-	-	-	-	+	+	-	-	-	-
20	QAZIM BUGARI	1243599769	PO	-	-	-	+	+	+	+	+	-	-	-	-
21	SHQIPRON BYTYQI	1231865509	PO	-	-	-	+	+	+	+	+	-	-	-	-
22	URIM SPAHIJA	1236333563	PO	-	-	-	+	+	+	+	+	-	-	-	-

POSEDON GJITHSEJ 10 PUNËTOR

9/16/2020 3:56:35 PM

LISTA E PUNËTORËVE					
Nr.	Emri Mbiemri	Nr. Personal	Viti i lindjes	Eksperienca	Pozita
1	Bujar Spahija	1003223376	23.08.1974	22	Menagjer
2	Mergime Krasniqi	1231742812	06.10.1992	4	Arkitekte
3	Bahrije Spahija	1002937774	14.10.1977	10	Administratore
4	Ngadhenjim Hoti	1176325557	13.08.1990	3	Inxhinier-konstruktiv
5	Arben Spahija	1003223635	31.12.1979	18	Punetor
6	Fitore Krasniqi	1176723579	03.12.1989	2	Inxhinier-konstruktiv
7	Asllan Sellaj	1172740240	28.09.1988	11	Punetor
8	Albert Dulaku	2172107217	28.10.1986	12	Punetor
9	Enver Demiraj	1016502754	23.05.1973	25	Punetor
10	Fitim Rusi	1241048191	09.06.1998	3	Punetor
11	Altin Kabashi	1242195112	05.09.1996	4	Punetor
12	Berat Bytyqi	2500815917	16.09.1972	29	Punetor
13	Flurim Spahija	1243593669	18.07.2001	1	Punetor
14	Samet Zyberi	1007907962	13.01.1983	18	Punetor
15	Xhelal Hoti	1016503360	16.01.1967	34	Punetor
16	Malsor Susuri	1170794032	30.06.1987	14	Punetor
17	Sani Buduri	1030415864	12.04.1976	25	Punetor
18	Florim Berisha	1016175273	09.10.1971	27	Punetor
19	Fadil Musaj	1016504587	05.05.1976	24	Punetor
20	Avni Musaj	1016501910	25.11.1978	23	Punetor
21	Leonard Kastrati	1176704701	26.04.1991	7	Punetor
22	Besim Zogaj	1232126279	22.02.1993	4	Punetor
23	Lavdim Bugari	1244607108	02.07.1996	4	Punetor

24	Afrim Gega	1232142070	07.10.1969	29	Punetor
25	Ardit Demiraj	1242506983	04.10.2000	1.5	Punetor
26	Qazim Bugari	1243699769	12.01.1999	2	Punetor
27	Lulzim Bytyci	1233941405	15.02.1993	7	Punetor
28	Shqipron Bytyci	1231888809	19.01.1991	8	Punetor
29	Urim Spahija	1230833563	12.03.1993	5	Punetor
30	Myrt Morina	1007421148	01.07.1971	29	Punetor
31	Agim Trelaku	1003572788	06.11.1969	31	Punetor
32	Hamit Isufi	2005222217	01.09.1981	19	Punetor
33	Halim Buduri	1173677029	25.05.1988	9	Punetor
34	Besim Buduri	1230097646	15.05.1991	8	Punetor
35	Shpejtim Bytyci	1005710002	09.04.1979	18	Punetor
36	Besim Bytyci	1030634981	02.02.1975	17	Inxhinier-konstruktiv

SHOQËRIA PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA SH.P.K. "Lirau-ing" PRIZREN

ediBAU-ing
Kompania Ndërtimore - Construction Company

VENDIMI PËR MENAXHER TË PROJEKTIT

Prizren me datën 15.06.2020

"EdiBau-Ing" SH.P.K me seli në Prizren e regjistruar në Ministrinë e Tregëtisë dhe Industrisë me çertifikatë regjistrimi **Numri unik identifikues: 810974403, NRF.601597779**, emëron menaxher **ing. Besim Bytyci** të projektit:

Titulli: Furnizim me material ndërtimorë për ndërtimin e disa shtëpive të familjeve skamnore në Prizren.

Nr. prokurimit622-20-1764-1-1-1

"EdiBau-Ing" SH.P.K

DREJTOR :

Bujar Spahija

United Nations Interim
Administration Mission in Kosovo

Universiteti i Prishtinës
University of Prishtina

FACULTY OF CIVIL ENGINEERING AND ARCHITECTURE

DIPLOMA

IN UNIVERSITY EDUCATION
BESIM VELI BYTYÇI
BORN IN NISHOR-SUHAREKA ON 2 FEBRUARY 1975
REGISTERED IN THE ACADEMIC YEAR 1995/96
COMPLETED ALL THE REQUIRED EXAMINATIONS
AT THE FACULTY OF CIVIL ENGINEERING AND ARCHITECTURE
DEPARTMENT OF CIVIL ENGINEERING
CONSTRUCTION SECTION
ON 28 JUNE 2005 AND OBTAINED
THE UNIVERSITY TITLE
CIVIL ENGINEER

Average grade of studies 6.95
Diploma examination grade 10

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS

DIPLOMË

Ë KUALIFIKIMIT UNIVERSITAR

BESIM VELI BYTYÇI

LINDUR NË NISHOR-SUHAREKA MË 2 SHKURT 1975
REGJISTRUAR NË VITIN AKADEMIK 1995/96
MË 28. 6. 2005 I KA DHËNË PROVIMET E PARAPARA
PËR TË MBARUAR FAKULTETIN E
NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS
DEGA NDËRTIMTARI
DREJTIMI KONSTRUKTIV
DHE ME KËTË MERR KUALIFIKIMIN

INXHINIER I DIPLOMUAR I NDËRTIMTARISË

Nota mesatare gjatë studimeve 6.95
Nota e provimit të diplomës 10

PRISHTINË, MË 28 DHJETOR 2005, NR. 364

Dekani
Prof. Dr. Musa Stavileci

Prof. Dr. Jahi Hoxha
(Zyrtar i lartë i ngarkuar i Universitetit të Prishtinës)
Rektori

Nr.LRP.1297/2018

----------VËRTETIM I KOPJES NGA ORIGJINALI ----------

Unë Minir Zekolli, Noter, me seli në Suharekë, rr. "Hajdin Berisha", p.n., vërtetoj se kjo kopje është identike me dokumentin e prezentuar si Origjinal i dokumentit me **:Diplomë", në emër të Besim Veli Bytyçi, Nr.364.**----------

---

Dokumenti përbëhet nga 1 fletë me 1 faqe të shkruar në gjendje të rregult.----------

---

Dokumentin për vërtetim e ka prezentuar, **Besim Bytyçi, i** lindur me 02.02.1975 në Nishor Komuna e Suharekës, Shtetas i Kosovës, bartës i numrit personal 1030634981, identifikohet përmes letërnjoftimit nr.ID0304131, lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës.----------

---

Kompensimi i Noterit është llogaritë dhe paguar në shumë prej 1,18 Euro për faqe-konform nenit 27 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2012 për Tarifat e Përkohshme Noteriale.----------

Suharekë, më 23.02.2018 (Njëzet e tre Shkurt dymijë e Tetëmbëdhjetë).----------

NOTERI:

Minir Zekolli

I.SEFERI

NDËRMARRJA PËR PRODHIMIN E ELEMENTEVE NGA BETONI

Curriculum Vitae

Emri:	BESIM
Mbiemri:	BYTYQI
Datelindja:	02.02.1975
Vendlindja:	fsh. Nishor, Suhareke
Adresa:	fsh. Nishor, Suhareke
Tel:	044-366-535

Profesioni: INXHINJER I DIPLOMUAR I NDERTIMTARISE

Diploma: Fakulteti i Ndertimtarise dhe Arkitektures, Seksioni i Ndertimtarise, Drejtimi konstruktiv

Arsimimi:

- 28.06.2005, Universiteti i Prishtines, Fakulteti i Ndertimtarise dhe Arkitektures, Prishtinë, Drejtimi: Konstruktiv

Përvoja në punë:

- 2003-2005 Inxhinjer i ndertimtarise ne Ndermarrjen Ndertimore "Sopi", Mushtisht, Suhareke
- 01.01. 2006 Inxhinjer i ndertimtarise pran Ndermarrjes Prodhuese Ndertimore "I.SEFERI" Sh.p.k, Gjinoc, Suhareke

Objektivat/Kualitetet personale :

- Udheheqes dhe mbikeqyres i shume projekteve ne ndertime te uleta dhe te larta, si: rruge, kanalizime, ujesjellse, ura, objekte te ndryshme konstruktive etj.

Projektet e realizuara gjate viteve 2006-20015:

1. Mbikeqyres i autorizuar (nga kryesia e fshatit Sllapuzhan) per punimet ne ndertimin e rruges se fshatit Sllapuzhan, Suhareke, (1250 metra gjatesi), Vlera e projektit: 260.000, 00 Euro. (Shih Kontraten)
2. Mbikeqyres ne projektin: Rregullimi-rikonstruktimi i trupit te rruges se fshatit Gjinoc, Suhareke (faza e pare), (3100 metra gjatesi) Vlera e projektit: 230.000,00 Euro.
3. Mbikeqyres ne projektin: Ndertimi i rruges dhe instalimeve nentoksore KFOR-Tranzit, pjesa e II ne Prizren, (1200 metra gjatesi), Vlera e pergjithshme e projektit: 981.631,27 Euro.
4. Ndertimi i rruges"Tranzit i Vjeter" - loto I: 1.594,795,77€.
5. Ndertimi me asfalt I rruges Dardani-Lubizhde te Prizrenit: 179.756,42€
6. Ndertimi i rrugeve lokale ne Mushtisht: 149.782,70€
7. Ndertimi i rrugeve ne qytetin e Rahovecit: 455.965,25€
8. Ndertimi i trotuareve ne qytetin e Rahovecit: 199.065,51€
9. Ndertimi i rrugeve ne lagjen e UQK-se ne Prizren: 249.507,99€
10. Ndertimi I rrugeve ne fshatin Apterushe dhe segmenti i mbetur ne Retije-Ritenderim: 338.233,05€
11. Ndertimi me elemente betoni I rrugeve ne lagjen Hajzeraj dhe Gutaj ne Nashec: 61.755,54€

Gjuhët e huaja: Shqipe, Serbokroate.

Patent shoferi: Kategoria "B"

Aftësitë kompjuterike: MS Office, MS Word, MS Excel, Auto Cad, ArCON, ARCICAD, Tower, Armkad etj.

Nenshkrimi,

Besim Bytyqi, IDN

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria e Shërbimeve Publike (tel:029-226 482) dt.10.07.2014

REFERENCË

Për:

Mbikqyrje dhe menaxhim të projekteve

Besim Bytyqi, ing.dipl.ndërt.

Duke u bazuar në përvojën që kemi pasur gjatë realizimit të projekteve të infrastrukturës rrugore ku si menagjer dhe mbikqyrës I tyre ka qenë z.Besim Bytyqi – ing.dipl.ndërt, Kuvendi Komunal I Prizrenit - Drejtoria për Shërbime Publike lëshon këtë Referencë:

Z. BESIM BYTYQI – ing.dipl.ndërt. ing.dipl.ndërt. ka bërë menaxhimin dhe mbikqyrjen e punimeve ndërtimore gjatë vitit 2012-2013 në këto projekte :

1	"Ndërtimi I rrugës në fshatin Malësi e Re - Prizren"	622-12-297-521	15,889.50 (€)
2	"Ndërtimi me elemente betoni i rrugës Alajdin Xhezairi – te bazeni"	622-12-096-521	49,728.13 (€)
3	"Ndërtimi me elemente betoni i rrugës Martirët e Kabashit - Prizren"	622-12-153-521	19,175.00 (€)
4	"Ndërtimi me elemente betoni I rrugëve në lagjen Bajram Curri"	622-12-282-521	51,366.96 (€)
5	"Ndërtimi me elemente betoni I rrugëve në lagjen Hajzeraj dhe Gutaj"	622-13-251-521	61,755.54 (€)
6	"Ndërtimi me elemente betoni I rrugës në lagjen Zekaj"	622-13-318-521	52,676.50 (€)

Realizimi I këtyre projekteve është kryer sipas kontratës dhe në afat të paraparë kohorë duke I zbatuar rregulloret dhe standardet teknike për këtë lloj të punimeve.

Jemi të bindur se Z. Besim Bytyqi – ing.dipl.ndërt. është I aftë dhe i kualifikuar për menagjimin dhe mbikqyrjen e projekteve të rrugëve me infrastrukturën përcjellëse dhe ne i preferojmë të gjitha organizatat dhe institucionet e tjera të cilat kanë nëvojë për bashkpunim në lëmin e ndërtimit të rrugëve.

Organi mbikqyrës:

Hatixhe Përzhella, ing.dipl.ndërt.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Kosova Cumhuriyeti
Republic Of Kosovo

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren-Prizren Belediyesi
Municipality Of Prizren

Drejtoria e Shërbimeve Publike (tel:029-226 482) dt.22.04.2010

REFERENCË

Për:

Mbikqyrje dhe menaxhim të projekteve

Besim Bytyçi, ing.dipl.ndërt.

Duke u bazuar në përvojën që kemi pasur gjatë realizimit të projekteve të infrastrukturës rrugore ku si menagjer dhe mbikqyrës I tyre ka qenë z.Besim Bytyçi – ing.dipl.ndërt,

Kuvendi Komunal I Prizrenit - Drejtoria për Shërbime Publike lëshon këtë Referencë:

z.Besim Bytyçi – ing.dipl.ndërt. është obliguar që të bëjë ndërtimin e rrugës dhe infrastrukturës përcjellëse dhe atë:

1. "Ndërtimi me asfallt i rrugës Ismet Jashari Kumanova – LOT 2 në Prizren në vlerë 355.114,16€;
2. Ndërtimi I infrastrukturës complete dhe rrugës "KFOR - Tranzit" në vlerë 981.631,27€;
3. Ndërtimi I infrastrukturës complete dhe rrugës "BenAf-Udhëkryqi I Nashecit" në vlerë 720.422.26€;
4. Ndërtimi I rrugëve lokale në fshatin Zhur në vlerë 1.140.079,91€;
5. Ndërtimi I infrastrukturës dhe rrugës Wiliam Walker - LOT 1 në vlerë 1.140.079,91€;
6. Ndërtimi I rrugës "Prizren - Gërnqare" në vlerë 458.522,00€;
7. Ndërtimi I rrugës "Aziz Kelmendi" në vlerë 89.590,70 € ;

Realizimi I këtyre projekteve është kryer sipas kontratës dhe në afat të paraparë kohorë duke I zbatuar rregulloret dhe standardet teknike për këtë lloj të punimeve.

Jemi të bindur se z.Besim Bytyçi – ing.dipl.ndërt, nga Theranda është I aftë dhe i kualifikuar për menagjimin dhe mbikqyrjen e projekteve të rrugëve me infrastrukturën përcjellëse dhe ne i preferojmë të gjitha organizatat dhe institucionet e tjera të cilat kanë nevojë për bashkpunim në lëniin e ndërtimit të rrugëve.

Organi mbikqyrës:

Hatixhe Përzhella, ing.dip.ndërt.